

Intervistë e kandidatit për kryetar të Prishtinës nga AKR-ja z.Ibrahim Makolli dhënë për Kosovapress



Kandidati për kryetar të Prishtinës nga Aleanca Kosova e Re (AKR), Ibrahim Makolli në një intervistë për Kosovapress, ka thënë se do t'i mundë kundërshtarët e tij politik dhe do të drejtë kryeqendrën. Megjithatë, bindjen për fitore, Makolli e lidh edhe me emrin e Behxhet Pacollit. Ai e pranon se edhe Muhamet Mustafa ka qenë një ndër emrat e lakuar për postin e kryetarit të komunës së Prishtinës, por sipas tij, organet drejtuese të AKR-së kanë vendosur që emri i tij të jetë kandidatë për kryeqendrën.

Kosovapress: AKR ju ka kandiduar për kryetar të Prishtinës. Çka do të thotë kjo kandidaturë për ju?

Makolli: Kandidimi im për kryetar të Komunës së Prishtinës është një vullnet i strukturave udhëheqëse të partisë dhe e kam pranuar këtë kandidaturë duke e kuptuar po ashtu edhe si një sfidë individuale, por edhe kolektive për të garuar për postin më të lartë të kryeqendrës, që nënkupton edhe një betejë për ndryshime në Prishtinë, duke pasur parasysh gjithnjë rëndësinë që ka kryeqyteti

dhe jetën e qytetarëve.

Mendoj se Prishtina është shndërruar në një qytet të pajtueshëm, të zhurmës, një qytet me mungesë të infrastrukturës, një qytet që banorëve të saj nuk iu ofron as parakushte për një jetë të dinjitetshme. Prandaj, kandidimi tim e kuptoj edhe si një sfidë për të ndryshuar dhe për të krijuar mundësi për një jetë krejt ndryshe.

Kosovapress: A e keni pritur një kandidaturë të tillë?

Makolli: Jo. Kandidatura ka ardhur si vullnet i strukturave të partisë dhe natyrisht se unë e kam pranuar këtë kërkesë, por që nuk e kam menduar asnjëherë se do të jem një nga kandidatët të mundshëm për kryetar të Prishtinës.

Kosovapress: Po, pse nuk e keni pritur një kandidaturë për kryetar të Prishtinës?

Makolli: Po unë për veten time se kam pasur as si objektiv të them të drejtën kandidaturën për postin e kryetarit të Prishtinës, por kjo erdhi nga vullneti i strukturave më të larta të partisë, të cilat kërkuan që unë të pranoj këtë post, për çka edhe jam pajtuar.

Kosovapress: Sa është e vërtetë që AKR ka vendosur në momentin e fundit që ju të jeni kandidati për Prishtinë, mbase janë lakuar emra të tjetër?

Makolli: Ne e kemi theksuar disa herë se brenda AKR-së ekziston një numër i kandidatëve të përshtatshëm për kreun më të lartë të komunës, ku një ndër ta ka qenë edhe Muhamet Mustafa, i cili ka qenë një nga kandidatët e mundshëm, por që natyrisht udhëheqja e AKR-së ka menduar se cili kandidat do të ishte më i pranueshëm që të jetë për postin e kryetarit të Komunës, ku si rezultat i saj jam nominuar unë. Përndryshe, kemi pasur një numër të madh të kandidatëve që janë lakuar, por që përfundimisht është vlerësuar se kandidati më i pranueshëm jam unë.

Kosovapress: Mendoni që me kandidatët që kanë hyrë në listën zgjedhore, AKR do të fitojë përqindje të konsiderueshme?

Makolli: AKR ka një vizion të qartë për të ardhmen e Kosovës, një vizion që është krejt ndryshe nga ato që kemi parë deri tash, një vizion i cili jetën e qytetarëve e bën më të lehtë. Po ashtu, AKR ka potencial edhe kadrovik edhe profesional, politik dhe programor që t'i bëjë këto ndryshime, dhe kujtoj se votuesit në mesin e shumë ofertave të ofruara nga subjektet politike të përfaqojnë edhe ofertën e AKR-së, e cila mund të bëjë ndryshime të rrënjësishme në gjithë Kosovën. Besoj se vizioni i AKR-së është vizion edhe i qytetarëve të Kosovës.

Kosovapress: Kjo do të thotë se nuk parashihni ndonjë rrezik për kalimin e pragut zgjedhor prej 5 për qind?

Makolli: Jo, është e thjeshtë të thuhet një jo, edhe një po. Por, po them se besoj shumë që qytetarët e Kosovës do të dinë ta vlerësojnë dhe përfaqojnë programin e AKR-së, i cili mbështetet kryesisht në zhvillimin ekonomik në vend dhe besoj shumë në këtë si qytetarët. Si program është një program për qytetarët e Kosovës dhe për ndryshime, të cilat mund të realizohen vetëm me një bashkëpunim me qytetarët.

Kosovapress: Mendoni se me programin që keni, do të arrini që t'i mundni kundërshtarët e juaj politik për postin e kreut të komunës së Prishtinës?

Makolli: Kam bindjen se programi i AKR-së për Prishtinë do të ngadhënjejë dhe jam bartës i kësaj filozofie, për çka besoj se votuesit do të vlerësojnë drejt se cila është oferta më e pranueshme. Vërtet, i vlerësoj shumë kundër-kandidatët të cilët janë në garë për postin e kryetarit të komunës së Prishtinës, dhe për të kaluarën dhe të tashmen e tyre, por konsideroj se ne kemi program më të qartë dhe ofertë më të realizueshme. Prandaj, si rezultat i kësaj, nuk dyshoj në suksesin që do të ketë AKR dhe unë. Përndryshe duhet kuptuar gara politike dhe se AKR si subjekt i ri politik në skenën politike mund t'i ofrojë qytetarit më shumë se sa të tjerët. Kur them këtë, kam parasysh se tash e tutje ne kemi parë se çka kanë qenë të gjendje të ofrojnë këto subjekte politike, prandaj në raport me këtë jemi në epërsi.

Kosovapress: Çka do të kishit ndryshuar në Prishtinë nëse i fitoni zgjedhjet?

Makolli: Me duhet të them se qytetarëve të Kosovës tash e shumë vite iu premtohet gjithçka dhe në të vërtetë nuk realizohet asgjë. Andaj, qytetarët e Kosovës kanë nevojë për përmirësim të infrastrukturës dhe të ndryshohet kjo ngulfatje që ekziston në Prishtinë, me këto ndërtime ilegale dhe ngushtim të hapësirës për jetës, me mungesë të rrugëve të qëndrueshme, probleme në administratë etj., që në botën e civilizuar këto probleme qysh prej vitesh janë tejkaluar.

Ne për çdo ditë përballemi me mungesë të ujit, dritës, kanalizimeve e dhjetëra e dhjetëra probleme të tjera që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve. Është e pranueshme që të kemi edhe rrugë të shtruara me granit, por në radhë të parë do të duhej të kemi rrugë të kalueshme, pastaj të kalojmë në granit. Jeta në Prishtinë thënë shkurt është një fasadë, sepse posa largohesh nga rruga qendrore ballafaqohesh me realitetin.

Kosovapress: Bindjen tuaj për fitore a e lidhni edhe me emrin e Behxhet Pacollit?

Makolli: Është edhe kjo që thoni ju, sepse Pacolli ka dhënë prova që është njeri i ndryshimeve dhe ka dhënë prova se si duhet ndërtuar Kosova. Megjithatë, qytetarët e Kosovës duhet të kenë besim në programin që e ofron AKR dhe pastaj është shumë e rëndësishme se kush qëndron prapa atyre programeve. Behxhet Pacolli ka ndërtuar pjesë të ndryshme të botës, prandaj dinë ta ndërtojë edhe Kosovën dhe Prishtinën.

Kosovapress: Përmendët ndërtimet ilegale. Në rast fitoreje, çfarë do të bëni me to, do t'i rrënoni apo çka?

Makolli: Prishtina mjaft është e rrënuar. Ajo ka nevojë për ndërtim. Duhet të studiohen të gjitha këto ndërtime që janë bërë, nuk duhet të fajësohen qytetarët, por duhet të shihet defekti ku ka qenë dhe pas studimit e vlerësimit të ndërmerren hapat e tjerë. Ndoshta është koha që të thuhet mjaft më me rrënim dhe gjithë ato që pengojnë.

Esenca e gjithë kësaj është që të lidhet kontratë me qytetarin dhe aty ku shihet që këto premtime pengojnë jetën e përditshme të qytetarëve, duhet të gjendet një formë për tejkalimin e saj, ndërkaq ku vlerësohet se nuk janë pengesë për jetën, atëherë natyrisht që duhet të legalizohen me ligjin dhe planin urbanistik, i cili gjithsesi duhet të studiohet.

Kosovapress: Si e vlerësoni punën e deritanishme të kreut aktual të KK-të Prishtinës, Ismet Beqiri?

Makolli: Nuk konsideroj se mund të jem një vlerësues për punën e dikujt tjetër, por mjafton që të jetohej 24 orë në Prishtinë dhe të shihet se çfarë është bërë deri më tani. Por pavarësisht gjithë kësaj, besoj që gjykuesi më i mirë për të tashmen e Prishtinës është qytetari, i cili mund ta vlerësojë më datën 17 nëntor. Ai është gjykimi më i mirë dhe të gjitha gjykimet tjera mund të jenë subjektive.

Kosovapress: Mendoni që qytetarët e Kosovës nuk do të dalin edhe aq shumë në zgjedhje, për shkak të shumë pakënaqësive dhe zhgënjimeve të tyre për proceset politike në vend?

Makolli: Kujtoj pikërisht që do të ndodhë e kundërta. Njerëzit, të cilët janë të pakënaqur me këto zhvillime dhe numrit të pakënaqur me këto zhvillime është mjaft i madh. Besoj që njerëzit, pikërisht të pakënaqur me këto zhvillime, do të dalin masovikisht në zgjedhje për të ndryshuar këtë gjendje. E vetmja mundësi e qytetarit për të ndryshuar ofrohet përmes zgjedhjeve, andaj qytetarët e Kosovës duhet të dalin në zgjedhje, për të paraqitur vullnetin e tyre përmes identifikimit, përmes subjekteve politike ose kandidatëve për të bërë ndryshime. Asnjë klasë politike nuk mund të bëjë ndryshime nëse këto ndryshime nuk i bën vetë elektorati.

Besoj se qytetari i Kosovës këtyre zgjedhjeve do t'u përgjigjet me një dalje masive me kohë për të bërë ndryshimet që kërkohen, andaj zërat që në këto zgjedhje nuk do të dalë numër i mjaftueshëm, unë nuk i vlerësoj të drejta.

Kosovapress: A mendoni se AKR do të bëjë ndonjë koalicion në të ardhmen?

Makolli: E gjitha mbetet të shihet pas mbajtjes së zgjedhjeve, dhe natyrisht ne si subjekt politik nuk përjashtojmë mundësinë për ndërtim koalicioni me subjekte tjera, sepse ai i cili me një formë ose tjetër do të

përcaktojë formën ose përbërjen në këto zgjedhje, do të jetë vetë vota e elektoratit dhe me këtë votë atëherë do të ndërtohen edhe koalicionet e mundshme.

Ne nuk përjashtojmë mundësitë për formimin e koalicioneve të tilla. Natyrisht jemi të interesuar që mos të dëmtojmë programin tonë, sepse ka rrezik që ai mos të jetë kompaktibil dhe të ketë vështirësi në realizimin e saj, por të shohim se me cilat subjekte politike mund të hyjmë në koalicion për të jetësuar në praktikë programin e AKR-së.

Kosovapress: Me cilën parti jeni më të afërt dhe që do të mundeshit të lidhni edhe koalicion?

Makolli: Nuk kemi asnjë paragjykim për asnjë subjekt politikë në Kosovë. Ne jemi subjekte politike që veprojmë këtu. Nuk kemi po ashtu edhe preferenca, por kemi raporte shumë të mira me të gjitha subjektet politike, por natyrisht gjithmonë identifikohen subjektet me të cilat do të mund të realizohet ideja, programi dhe vizioni që kemi.

Kosovapress: Mendoni se zgjedhjet kanë ardhur në një moment jo aq të përshtatshëm dhe se kanë qenë të imponuara nga faktori ndërkombëtar?

Makolli: Vërtet mendoj se nevoja për mbajtjen e zgjedhjeve ka qenë ndoshta edhe më herët për shkak të këtij "gërçi" që e ka kapluar skenën politike kosovare dhe institucionet në përgjithësi. Prandaj, kur them se zgjedhjet është dashur të mbahet qysh më herët, kam parasysh edhe skadimin e mandatit të pushtetit lokal dhe çështja e dytë ka të bëjë me rastin e ndarjes së LDK-së ku në shumicën e komunave të Kosovës kemi pasur të bëjmë me një bllokadë totale të funksionimit të institucioneve lokale.

Ligjërisht, zgjedhjet do të duhej të mbahen në këtë vjeshtë. Ne kemi vlerësuar gjithashtu se mbajtja e zgjedhjeve nuk do të dëmtojë procesin e statusit, përkundrazi hap rrugë dhe përshpejton procesin e statusit, kur kihet parasysh humbja e besueshmërisë të drejtuesit e institucioneve nga ana e qytetarëve dhe nevoja që elektorati të bëjë ndryshime pozitive. Asnjë prej neve nuk është i interesuar që të dëmtojë definimin e statusit, sepse kjo është prioritarë për të gjithë neve.

Kosovapress: Mendoni se Kosova do të konstituohet me institucione në dhjetor të këtij viti?

Makolli: Pse nuk mund të konstituohen kur ligji parasheh edhe afatin e konstituimit të institucioneve? Andaj, nuk mund askush të jetë mbi ligjin dhe të gjithë duhet të respektojnë atë.

Kosovapress: Dhe, krejt në fund, a mendoni se Kosova do të jetë e pavarur në dhjetor të këtij viti?

Makolli: Kosova do të pavarësohet dhe për këtë nuk ka asnjë dilemë, por kur do të ndodhë kjo, është çështje që nuk varet krejtësisht nga ne. Lidhja me data e ka dëmtuar procesin dhe ka rezultuar me humbje të besueshmërisë në institucionet ekzistuese. Me rëndësi do të jetë finalja, ndërkaq se a do të jetë këtë vit, për çka besojmë se do të jetë këtë fundvit, kjo mbetet të shihet. /Intervistuan: Lumturie Blakaj-Mirjeta Dervishi.